



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Nr. 1794 prot.

Lezhë, më: 15/11 2023

**NJOFTIM**

**“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PYJORE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE KOLSH DHE ZEJMEN”**

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetqëverisjen vendore”, në ligjin Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në VKM 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, në ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, si dhe në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr.13828/2 prot, datë 13.11.2023 “Për dhënie e dakortësisë për vijimin e procedurave, për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për Pyjet”, Njësia e Administrimit, Bashkia Lezhë të Pyjeve ka ndërmarrë nismën për vlerësimin e sipërfaqes pyjore potenciale për zhvillimin e veprimtarisë së sipërmarrjes, për vendosjen e aerogjeneratorëve (park eolik).

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e mërkure, **datë 05.12.2023, ora 10:00**, në ambientet e **Qendrës Kulturore të Fëmijëve**. Gjatë takimit të dëgjesës publike do bëhet prezantimi i dokumentave të hartuara nga Njësia e Administrimit të Pyjeve me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, shfrytëzim të burimeve pyjore dhe plotësimin e nevojave të sipërmarrjes publike.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja !

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

